REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1473/4 Prot. Tiranë, më 26 . 10 . 2026

V E N D I M

Nr. 285, Datë 26 . 10 . 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 185, datë 28.07.2026, e paraqitur nga znj. E.P kundër Shkollës 9-vjeçare "Kushtrimi i Lirisë", Durrës, në të cilën pretendon diskriminimin e fëmijës së saj të mitur E.D, për shkak të *"gjendjes familjare", "gjendjes shëndetësore"* dhe *"çdo shkak tjetër"*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues pretendon se: *"Vajza ime, E.D, është nxënëse e Shkollës 9-vjeçare "Kushtrimi i Lirisë", Durrës. Me vendimin e datës 23.06.2026, ajo është detyruar të përsërisë për herë të dytë klasën e VII-të, me arsyetimin se kishte tejkaluar numrin maksimal të mungesave të parashikuara nga aktet nënligjore.*

Përpara marrjes së vendimit, kam informuar zyrtarisht shkollën dhe autoritetet përkatëse për situatën e vajzës sime, duke paraqitur dokumentacionin përkatës dhe duke kërkuar që rasti i saj të shqyrtohej në mënyrë individuale, duke marrë në konsideratë rrethanat e veçanta në të cilat ajo ndodhej. E.D është përballur me pasoja të rëndësishme emocionale dhe familjare si pasojë e divorcit të prindërve dhe ndryshimit të strukturës dhe mjedisit të saj familjar. Për më tepër, ajo ka pësuar një aksident me skuter, si pasojë e të cilit ka pësuar dëmtim të gjurit, ka pasur nevojë për trajtim mjekësor dhe fizioterapi, dhe për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, ka qenë e detyruar të mungojë në shkollë për një periudhë të konsiderueshme.

Në të njëjtën kohë, ajo është përballur me një ngarkesë të rëndë dhe të jashtëzakonshme emocionale për shkak të situatës së rëndë shëndetësore të vëllait të saj, G.D, i cili është diagnostikuar në Itali me limfomë folikulare pediatrike dhe ka kaluar një proces të rëndësishëm

trajtimi mjekësor. Kjo situatë familjare ka ndikuar drejtpërdrejt në gjendjen emocionale dhe psikologjike të E.D.

Përveç këtyre rrethanave, institucionet kanë qenë në dijeni se E.D ka pasur nevojë për mbështetje të veçantë psikosociale. Ajo është identifikuar si fëmijë në rrezik për braktisje shkollore, janë aktivizuar mekanizmat përkatës të mbrojtjes së fëmijës dhe është përfshirë shërbimi psikosocial.

Pavarësisht se këto rrethana kanë qenë të njohura dhe të dokumentuara, vendimmarrja e shkollës është mbështetur kryesisht në zbatimin formal të kritereve të mungesave, pa u kryer një shqyrtim i plotë dhe individual i situatës dhe pa u vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme ndikimi që rrethanat e saj të veçanta kanë pasur në frekuentimin dhe ecurinë e saj shkollore.

Gjithashtu, nuk është marrë në konsideratë ndikimi që përsëritja për herë të dytë e së njëjtës klasë mund të ketë mbi zhvillimin emocional dhe psikologjik të një fëmije që tashmë ndodhet në një situatë të rënduar familjare, shëndetësore dhe psikosociale, si dhe mbi të drejtën e saj për të vazhduar arsimin dhe për t'u integruar në mënyrë të qëndrueshme në procesin mësimor.

Në këto kushte, vlerësoj se mënyra e trajtimit të rastit të vajzës sime ka krijuar një situatë veçanërisht të pafavorshme për të, pasi rrethanat e saj të veçanta familjare, shëndetësore dhe psikosociale nuk janë marrë në konsideratë në mënyrë të plotë gjatë procesit të vendimmarrjes".

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe rishqyrtimin e vendimmarrjes së Shkollës 9-vjeçare "Kushtrimi i Lirisë", Durrës, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat individuale dhe dokumentacionin përkatës të rastit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Shkaqet e pretenduara nga ankuesja, janë shkaqe të mbrojtura nga neni 1, i ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".*

Bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, parashikohet se: *"2. "Diskriminim i drejtpërdrejtë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji".*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që

krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1473/1, datë 19.08.2026, Komisioneri, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Shkolla "Kushtrimi i Lirisë", Durrës, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Me shkresën nr. 1473/2, datë 08.10.2026, Komisioneri, ka rikujtuar Shkollën "Kushtrimi i Lirisë", Durrës, për dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar.
- Me email-in datë 13.10.2026, Shkolla "Kushtrimi i Lirisë" ka informuar Komisionerin se: *"Informacionit dhe dokumentacionit lidhur me shkresën nr. 1473/1 datë 18.08.2026, i jemi përgjigjur me shkresën nr. 578, datë 19.08.2026, dërguar pranë ZVAP Durrës. Ju informojmë se nxënësja E.D është rikthyer në shkollë dhe po e frekuenton atë rregullisht. Nga ana e institucionit arsimor po i ofrohet mbështetja e nevojshme mësimore, psikologjike dhe sociale, në bashkëpunim me stafin pedagogjik dhe shërbimin psikosocial, me qëllim lehtësimin e përshtatjes së saj në mjedisin shkollor, plotësimin e nevojave individuale dhe vijimin e suksesshëm të procesit mësimor".*
- Me shkresën nr. 620, datë 13.10.2026, Shkolla "Kushtrimi i Lirisë", ka dërguar dokumentacionin e kërkuar.

Në dokumentacionin e dërguar rezulton se Komisioni për Shqyrtimin e Rastit të Nxënëses E.D, i ngritur me Urdhrin nr. 7, datë 16.09.2026 të Drejtorit të Shkollës "Kushtrimi i Lirisë", me proces verbalin datë 16.09.2026, në mes të tjerash ka vendosur që: *"2. Të propozojë/regjistrojë nxënësen E.D, në klasën e VIII-të, në përputhje me grup-moshën e saj"*.

Në vijim të trajtimit të ankesës, subjekti ankues me email-in datë 20.10.2026 ka informuar se: *"Dëshiroj t'ju informoj zyrtarisht se situata është përmirësuar, pasi vajza ka kaluar në klasën e VIII-të. Për këtë arsye, ju informoj se ankesa tashmë konsiderohet e plotësuar. Ju falënderoj për vëmendjen dhe trajtimin e çështjes së paraqitur pranë institucionit tuaj".*

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *"Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa"*, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" parashikohet përfundimi i procedurës administrative: "Procedura administrative, e*

nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ".

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"*, i cili parashikon se: *"Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë"*, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 185, datë 28.07.2026, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese ka konsideruar se është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore[1].

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"*, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja b), nenin 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 185, datë 28.07.2026, të znj. E.P kundër Shkollës 9-vjeçare "Kushtrimi i Lirisë", Durrës, në të cilën pretendon diskriminimin e fëmijës së saj të mitur E.D, pa një vendim përfundimtar për çështjen, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

[1] Për analogji shih vendimet: nr. 221, datë 17.08.2026 dhe nr. 258, datë 22.09.2026 të KMD-së.